



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.17/2017

Prishtinë, më 29 mars 2018

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Frashër Krasniqi, Saranda Bogujevci, Mirjeta Kalludra, Mexhide Mjaku-Topalli, Luljeta Veselaj-Gutaj, Teuta Haxhiu, dhe Albulena Balaj- Halimaj.

Mungoi: Miljana Nikoliq.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë:

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e komisionit.

Anëtarët e komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e komisionit, andaj komisioni i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L- 031 për Lirinë fetare në Kosovë.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryetarja konstatoi se procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 12 mars 2018, u miratuan pa vërejtje.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L- 031 për Lirinë fetare në Kosovë

Kryetarja, tha se jemi këtu sërish për shqyrtimin dhe miratimin e këtij projektligji dhe amendamentin e propozuar nga deputeti, Nait Hasani.

Në grupin punues kemi votuar kundër këtij propozimi, nuk kemi pasur mundësi të gjejmë prova të mjaftueshme në favor të këtij amendamenti dhe kjo është arsyeja që kemi votuar kundër dhe tani në mungesë të provave do të votojmë edhe njëherë si komision.

Por, kur të plotësohen kushtet, kjo nëse vërtetohet, me ligj kanë të drejtë të regjistrohen si bashkësi e re fetare, sepse ligji e lejon këtë mundësi.

Lirije Kajtazi, tha se si komision na janë dashur më shumë prova, ka qenë lehtësim për ne ardhja e Kryegjyshit Botërore të Komunitetit Bektashian dhe kemi qenë fleksibil dhe në atë drejtim kemi vendosur për komunitetin bektashian.

Amendamentit të propozuar nga deputeti Nait Hasani, nuk i ndalet rruga. Ai procedohet për votim në seancë dhe ne mund të fitojmë në kohë dhe të marrim argument shtesë dhe më pas vendoset në seancë.

Jemi me vonesë, por sidoqoftë, edhe lidhja e historianëve dhe akademikët kanë shprehur gatishmërinë që të na ndihmojnë në këtë drejtim.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se pas përfundimit të këtij projektligji, është mirë të takohemi me akademikë dhe historianë dhe të diskutojmë, sepse këto çështje kanë të bëjnë edhe me Ligjin për trashëgiminë kulturore dhe të shohim se çka mund të bëhet më tutje, lidhur me këtë çështje.

Frashër Krasniqi, bëri pyetje se a mund të bëjë propozim për amendamentim që të regjistrohet e të trajtohet në mënyrë të barabartë në Projektligjin për liritë fetare edhe kisha ortodokse e Kosovës dhe ky propozim të dërgohet në seancë.

Kryetarja, tha se ky propozim nuk ka kaluar në grupin punues dhe afati për të paraqitur amendamente nga deputetët ka kaluar, për kishën ortodokse të Kosovës nuk kemi provë argumentimi në favor të saj.

Luljeta Veselaj- Gutaj, tha se 14 ditë pas leximit të parë në Kuvend të një projektligji, ka afat ligjor për deputetët të dorëzojnë amendamentet, nëse kanë. Po ashtu, kemi diskutuar, por nuk ka pasur diçka konkrete për propozimin që të jetë kisha ortodokse e Kosovës.

Ne kishim dilema edhe për komunitetin bektashian, por pas gjithë atyre dokumenteve historike që i ka paraqitur Kryegjyshata Botërore Bektashiane, me seli në Tiranë, kemi vendosur që të bëjmë amendament.

Kryetarja, tha se po e vendosim në votim, prapë amendamentin e deputetit Nait Hasani, që të regjistrohet e të trajtohet në mënyrë të barabartë në Projektligjin për lirinë fetare edhe Kisha Ortodokse Shqiptare në Kosovë.

Kryetarja, konstatoi se rezultati i votimit për këtë amendament ishte si vijon: 1 votë për, 5 vota janë kundër dhe 3 vota abstenim.

Ajo konstatoi se amendamenti i deputetit Nait Hasani, të procedohet në seancë, pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.

Ajo hodhi pastaj në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lirinë fetare në Kosovë, bashkë me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte: 8 vota për, 1 votë abstenim dhe 0 vota kundër.

Kryetarja konstatoi se komisioni miratoi Projektligjin me amendamentet e miratuara dhe procedimi vazhdon në komisionet e përhershme të Kuvendit.

Të ndryshme

Kryetarja njoftoi për vizitën që kishte bërë në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe propozoi që të mbahet një tryezë me disa nga bizneset e përpunimit dhe importimit të mishit, sepse mund të ketë ndonjë element se ndonjëri nga ta nuk respektojnë vetëkontrollin e brendshëm që e kanë obligim.

Ajo propozoi që në këtë tryezë të ftohen: Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, drejtori i Doganave, Oda Ekonomike e Kosovës, Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe së paku 10 subjekte të bizneseve. Kjo tryezë të mbahet para debatit parlamentar për këtë çështje.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Duda Balje